

## **Ku paraqitet kërkesa?**

Gjykata vihet në lëvizje me anë të kërkesës për informacion, e cila mund të paraqitet në formë elektronike siç e parashikon Ligji.

Individi i cili dëshiron të paraqesë kërkesën dorazi, mund të paraqitet pranë Gjykatës, në Sekretarinë Gjyqësore dhe të Dokumentacionit, çdo ditë pune, nga ora 08.00-16.00.

## **A ka një model për hartimin e kërkesës për Informacion në Gjykatë? Nëse po, ku mund ta gjej atë?**

Në faqen zyrtare të Gjykatës [www.gjp.gov.al](http://www.gjp.gov.al) gjendet formulari i paraqitjes së kërkesës, si dhe këshilla praktike për plotësimin e tij, të cilat, gjithashtu, kanë karakter orientues dhe jo detyrues. Kërkuesi mund të paraqitet edhe pranë gjykatës për të tërhequr një model të Formularit, por Gjykata nuk mund ta ndihmojë në plotësimin e tij.

Kërkesat për Informacion duhen të paraqitet në formë të shkruar në gjuhën shqipe, qartë e kuptueshëm dhe duhet të përmbajë:

- emrin dhe adresën e Gjykatës;
- emrin, mbiemrin ose emërtimin, vendbanimin ose vendqëndrimin e kërkuesit;
- objektin e kërkesës dhe bazën ligjore;
- nënshkrimin e kërkuesit.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë) të kërkuesit.

## **A informon Gjykata se kërkesa është paraqitur në mënyrë të rregullt dhe është regjistruar?**

Vetëm në rast të paraqitjes së një kërkesë të paplotë, Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median njofton kërkuesin për plotësimin e saj brenda një afati 10-ditor. Në këto raste kërkesa konsiderohet e paplotë dhe nuk regjistrohet në regjistrin e kërkesave. Nëse kërkesa nuk plotësohet brenda afatit të caktuar ajo arkivohet.

## **E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar.**

### **Ligj nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”**

#### **Neni 11**

#### **Kërkesa për informim**

1. Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij. Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, të parashikuar në nenin 8 të këtij ligji.

2. Në çdo rast, kërkesa për informim regjistrohet dhe për të caktohet një numër rendor. Numri rendor, së bashku me të dhënat e kontaktit të koordinatorit për të drejtën e informimit, i jepet kërkuarit që ka bërë kërkesën për informim.

3. Kërkesat për informim regjistrohen sipas radhës së paraqitjes dhe trajtohen pa dallime mes tyre.

4. Kërkesa për informim duhet të përmbajë:

- a) emrin dhe mbiemrin e kërkuarit;
- b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;
- c) përshkrimin e informacionit që kërkohet;
- ç) formatin në të cilin preferohet informacioni;
- d) çdo të dhënë që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.

5. Në qoftë se kërkesa për informim nuk e përcakton formatin në të cilin kërkohet informacioni, ai jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.

**Koordinatori: Dinora Aleks**

**E-mail: [dinora.aleksi@gjp.gov.al](mailto:dinora.aleksi@gjp.gov.al)**

**Tel: +355696907288**

**Adresa: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Tiranë, Shqipëri.**

**Orari: E hënë – E premte 08:00-16:00**